

VENDIM
Nr. 563, datë 29.7.2022

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 177, DATË 6.3.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR AMBALAZHET DHE MBETJET E
TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 29, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“29. “Qese plastike mbajtëse”, ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

2. Pikat 29/a shfuqizohet.

3. Në kreun IV, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2, shfuqizohet.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pa rënë ndesh me kërkesat e tjera të posaçme të këtij vendimi, prodhimi i qeseve plastike mbajtëse, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë 70 mikron ose më të madhe se 70 mikron, me kapacitet mbajtës 10 kilogram, ose më të madh se 10 kilogramë dhe me përmasa 50 cm, ose më të mëdha se 50 cm gjatësi dhe 24 cm, ose më të mëdha se 24 cm gjerësi, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, bëhet duke përdorur jo më pak se 55% lëndë të parë, të përfutur nga riciklimi, ose lëndë të parë ndihmëse alternative joplastike.

c) Në pikën 4, fjalët “... të pikave 2 dhe 3 ...” zëvendësohen me fjalët “... të pikës 3 ...”.

ç) Pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Çdo prodhues/importues i qeseve plastike mbajtëse me karakteristikat, sipas pikës 3, të këtij kreu, të ketë skedën teknike për llojin e qeses plastike mbajtëse që prodhon/tregon dhe t’ia paraqesë strukturave inspektuese në rast inspektimi.”.

4. Në kreun VIII bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Prodhuesi ose importuesi lejohet të hedhë në treg apo të vendosë në qarkullim qese plastike mbajtëse, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, vetëm pasi sigurohet që në të janë të dukshme elementët e përcaktuar në aneksin 7, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

b) Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

5. Pikat 2 dhe 3, të kreut XV, shfuqizohen.

6. Në kreun XVI, pas emërimit “Inspektorati Qendror Teknik” shtohet termi “Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut”.

7. Në kreun XVII, pas termit “... të pikës 25” të shtohen fjalët “dhe 25/1 ...”.

8. Në shtojcën nr.4, në paragrafin e fundit, për rastin e qeseve plastike, hiqet fjalia: “Shenja për evidentimin e materialit ambalazhues, i cili është i biodegradueshëm”.

9. Pas aneksit 6, shtohet aneksi 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 7

SISTEMI I SHËNJIMIT NË QESËT PLASTIKE MBAJTËSE

1. Prodhuesi, importuesi lejohet të hedhë në treg, të përdorë apo të vendosë në qarkullim vetëm qeset plastike mbajtëse, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe me sistemin e shënjitimit si vijon:

a) Qese plastike mbajtëse me veshë me përmasa:

- a.1. me trashësi të mureve të qeses për çdo anë 70 mikronë, ose më të madhe se 70 mikronë;
- a.2. me kapacitet mbajtës 10 kilogramë, ose më të madh se 10 kilogramë;
- a.3. me përmasa 50 cm, ose më të mëdha se 50 cm gjatësi;
- a.4. 24 cm ose më të mëdha se 24 cm gjerësi, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve.



b) Qese plastike mbajtëse pa veshë me përmasa:



- b.1. me trashësi të mureve të qeses për çdo anë 70 mikron, ose më të madhe se 70 mikronë,
- b.2. me kapacitet mbajtës 10 kilogramë, ose më të madh se 10 kilogramë;
- b.3. me përmasa 50 cm, ose më të mëdha se 50 cm gjatësi;
- b.4. 24 cm ose më të mëdha se 24 cm gjerësi, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve.

2. Sistemi i shënjitimit për qeset plastike mbajtëse me ose pa veshë të përmendura më sipër, të jetë i pozicionuar në të majtë, poshtë me përmbajtjen, si vijon:

- a) inicialet identifikuese të prodhuesit dhe NUIS;
- b) shenjat treguese, që përcaktojnë llojin e plastikës, që është përdorur për prodhimin e qeses apo ambalazhit (PET, PP, PS etj.);
- c) datën, muajin dhe vitin e prodhimit;
- ç) shenjën identifikuese, që tregon se qesja është e riciklueshme dhe të depozitohet dhe mbledhur e ndarë nga mbetjet organike;
- d) shenjën, që tregon se qesja plastike është e prodhuar me parametra e parashikuara në pikën 3, të kreut IV, të këtij vendimi (gjatësi, gjerësi, kapacitet mbajtës dhe përqindjen e lëndës së parë të përdorur për prodhim).